



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politik dhe Financa

01Nr 06-1181919

Klinë: 25.03.2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 13.02.2019, me fillim nga ora 10:00, në sallën e Kuvendit Komunal

RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Ekzekutivit-Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit dhe Prokurimit për vitin 2018,
4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Ekzekutivit për 2019,
5. Shqyrtimi i Planit të punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi për vitin 2019,
6. Shqyrtimi i Planit të Punës së Prokurimit për vitin 2019,
7. Kërkese për shqyrtimin dhe inicim të procedurës për ndërrimin e destinimit nga objekti Afarist në Objekt Banimi, pjesën e Komunës, objekti NOJTRA,
8. Kërkesat e arritura KPF-së në muajin janar-shkurt 2019,
9. Të ndryshme.

Pjesëmarrës ishin anëtarët e Komitetit:

- 1-Fadil Gashi-Kryesues
- 2-Tunë Dedaj-anëtar
- 3-Vjoleta Zefi-anëtare
- 4-Blertha Gashi-anëtare

- 5-Enver Berisha-anëtar
- 6-Mendehie Duraku - anëtare
- 7-Xhevxhet Berisha – anëtar

Ndërsa, pjesëmarrës tjerë ishin: Z.Enver Gashi, z.Ajet Sejdiu, z.Arben Limanaj, z.Illir Bacaj, z.Zenun Zeqa, z.Lorenc Marleku dhe Perfaqses nga OSBE z. Driton Marku.

Kryesuesi Fadil Gashi: Bëri hapjen e mbledhjes ku përshëndeti të gjithë të pranishmit,drejtorët, OSBE-n Driton Markun, Shërbimin e Kuvendit, falënderoj edhe Tunë Dedaj për mbajtjen e mbledhjes së kaluar, theksoj se këtu nuk e kemi materialin për Këshillin Komunal të Sigurisë në Bashkësi, nëse ju pajtoheni mund të na sjellin në Komitetin e radhës ose ne seancën e Kuvendit.

Kemi katër kërkesa të qytetarëve dhe dy janë të institucioneve të ministrisë përkatëse, që kanë kërkuar që t'i përmirësojmë dy vendime të marra në Kuvend.

Tunë Dedaj: Përshëndeti të gjithë, kërkoi që ta rekomandojmë për Kuvend si pikë e rëndit të ditës, ndalimin e pirjes së duhanit në vende publike ose të respektohet ligji, i cili është në fuqi,ka qenë mirë të ndërmarrim ndonjë veprim në këtë aspekt.

Fadil Gashi: Tha se e përkrahi këtë propozim,do të mundohem ta gjejmë një zgjidhje,është ligji i cili e ndalon, por ne duhet të kërkojmë implementimin e Ligjit nga Inspektorati, ka qenë mirë të fillojmë nga objekti i Komunës, e pastaj edhe në vendet tjera.

Enver Berisha: Mendoj që ky rekomandim përmes jush të shkoj tek Bordi i ekzekutivit dhe ata që janë kompetentë duhet ta zbatojnë ligjin. Mendoj që është e paarsyeshme të diskutohet në asamble meqë është në përgjegjësi të Inspektoratit.

Fadil Gashi: Komiteti ta propozojë një rekomandim që ekzekutivi ta zbatojë ligjin nëse pajtoheni.

Të gjithë ishin pro këtij rekomandimi,

1. Arsyeimi i mungesave,

Të gjithë anëtarët ishin prezent.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

U shqyrtua dhe u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Ekzekutivit-Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit dhe Prokurimit për vitin 2018,

Ajet Sejdiu: Përshëndeti të gjithë! Raportin e ekzekutivit e kam formuar unë personalisht duke i marrë propozimet e drejtorive për pjesën hyrëse që e ka Kryetari e kemi punuar ne, kurse drejtorët e drejtorive janë këtu prezent, që ka dikush ndonjë pyetje ne mund t'i përgjigjem, por ne nuk kemi diçka që të shtojmë.

Enver Berisha: Meqenëse, këtu është një volum i madh i materialit, dhe realisht ne duhet ta pranojmë që është një material që detyrohem edhe në kuadër të grupeve parlamentare të bëhet analizimi dhe vlerësimi, kështu që ne në kuadër të komitetit nuk po mund t'i nxjerrim të gjitha sugjerimet tona, qëndrimet, vërejtjet, unë mendoj që kjo duhet të kalojë për seancë pa debat.

Arben Limanaj: Raportin e kemi dorëzuar në dy apo tri adresa dhe në raportin final e pash që disa ndryshime që i kemi bërë nuk janë evidentuar. Kërkoj që këto plotësime që janë bërë edhe pse i kemi bërë me kohë ndryshimet tek Ajeti nuk kanë shkuar me ndryshime nga ana e drejtorisë dhe raporti ka dalë pa ato ndryshime që i kemi bërë, këto ndryshime kanë të bëjnë me shumë me një program të grumbullimit të dhënave, suksesit të nxënësve që është një program që e menaxhon Ministria e Arsimit dhe ne nuk mundem të kem qasje në atë program që ta nxjerrim suksesin e shkollave, edhe pse variantin e parë e kemi dorëzuar pa suksese, kështu që këtë ndryshim ne duhet ta bëjmë patjetër.

Fadil Gashi: Meqë materiali po dërgohet për seancë keni ende kohë që ta plotësoni me ato ndryshime dhe në seancë me qenë i kompletuar.

Vjoleta Zefi: Përshëndeti të gjithë! Kërkoj që ndryshimet eventuale që ndodhin në secilën prej këtyre materialeve të na dërgohen para seancës.

Fadil Gashi: Duhet ta keni parasysh, sepse materialet do t'u vijnë në adresë elektronike.

Violeta Zefi: Zakonisht e kanë bërë praktikë që ne që jemi pjesë e KPF-së na i lanë këto materiale që i kemi, sepse e konsiderojnë që i kemi këto materiale, për këtë arsye thash që ato ndryshime që bëhen në materiale të na i sjellin edhe ato me ndryshime.

Fadil Gashi: Rekomandoj që Raporti i punës të kalojë për seancë.

Të gjithë ishin pro.

4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Ekzekutivit për 2019.

Fadil Gashi: Kam vërejtje në punimin e këtij materiali dhe kërkoj që të përmirësohen punimet dhe të sillen në seancë.

Tunë Dedaj: Gjate leximit të këtij materiali, tek Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport nuk më pëlqej, sepse nuk është parapare asnjë aktivitet për 17 Shkurt, pra për Ditën e Pavarësisë.

Enver Gashi: Propozoj që ky material të përmirësohet dhe të sillen në seancë, për të pas kohë të mjaftueshme ne duhet që ta shtyjmë seancën për një datë tjetër. Unë propozoj që ta shtyjmë për datën 28 shkurt.

Fadil Gashi: Hodhi në votim propozimin e Enver Gashit.

Të gjithë ishin pro këtij propozimi, që seanca të shtyhet për 28 shkurt, edhe për Shqyrtimin e Planit të Punës së Ekzekutivit për vitin 2019.

Të gjithë ishin pro që ky rekomandim të kalojë për në seancën e Kuvendit të Komunës.

5. Shqyrtimi i Planit të punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi për vitin 2019.

Fadil Gashi, theksoj se këtu nuk e kemi materialin për Këshillin Komunal të Sigurisë në Bashkësi, nëse ju pajtoheni mund të na sjellin në Komitetin e radhës ose në seancën e Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Planit të Punës së Prokurimit për vitin 2019,

Abaz Foniqi: Përsëritet të gjithë, tha se unë si praktikë dhe kërkesë ligjore është ta përgatis planifikimin e Prokurimit për vitin vijues, edhe Ligji i Prokurimit kërkon që në afatet e parapara me ligj të dorëzohet në faqen P., si dokument që parashihet të udhëhiqet me procedura të prokurimit për vitin 2019 në bazë të buxhetit të miratuar në këtë asamble dhe në bazë të kërkesave të drejtorive tona kemi arritur që në fund të finalizojmë planifikimin e Prokurimit, dhe kam arritur ta përfundojë me ndryshime me kërkesa të drejtorive. Kërkoj falje që materiali i parë iu ka ardhur i papërfunduar, ka qenë edhe një letër përcjellëse që kam sqaruar që është i papërfunduar, por për seancën e radhës është i përfunduar, ne mundë ta shtojmë ndonjë kërkesë tjetër që del nga asambleja, por mund edhe ta heqim. Mund të realizohen edhe projekte tjera nuk është ndalës administrative, formulari që e keni përpara është formularë unikë që sistemi e krijon, ne mund të ju themi që mos të ndaloni tek çmimet ose tekë zarfi, sepse ne e marrim një krahasim tekë kontratat e mëhershme, por këto nuk janë kontrata që do të lidhën në të ardhmen këto çmime janë vetëm simetrike, gjatë procedurave të tenderimit mund të vihen çmime më të ultë, më të larta, është një proces i tregut, për asamble do ta keni raportin final.

Fadil Gashi: Falënderoj Abaz Foniqin, hapi debat rreth Planit të Prokurimit.

Enver Berisha: Falënderoj Abazin për pjesën hyrëse, por vetë fakti që nuk është i kompletuar, ne vetëm mundë ta rekomandojmë për seancë,

Fadil Gashi: Kush është që ky propozim të rekomandohet për seancë.

Të gjithë ishin pro, që plani i Punës së Prokurimit të kalojë në seancë.

7. Kërkesë për shqyrtimin dhe inicim të procedurës për ndërrimin e destinimit nga objekti Afarist në Objekt Banimi, pjesën e Komunës, Objekti NOJTRA.

Lorenc Marleku: Përsëritet të gjithë! Nga fillimi i vitit të kaluar e kemi vizituar këtë objekt dhe kemi parë që domosdo aty duhet të ndërhyhet sepse është një hapësirë, e cila nuk mund të shfrytëzohet për afarizëm ne kemi aty afër 700 metra katrorë në katin e dytë tretë dhe të katërt, por shkak të pozitës asnjëherë nuk kemi mundur ta shfrytëzojmë, sepse nuk ka pamje nga rruga, pas shumë konsultimeve dhe ideve të ndryshme edhe me Bordin e drejtorëve kemi ardhur në përfundim që ajo të shndërrohet në ndertës banimi dhe ta bëjmë të shfrytëzueshme. Ne si Komunë kemi disa obligime ndaj disa personave fizikë të cilëve ju ka prish vendbanimi me herët dhe ka qenë dashtë të kompensohen me banesa, kjo ka ndodh para shumë viteve, disa ende janë në proces gjyqësor, dy prej tyre i kanë fituar dhe ne jemi të obliguar të ja kompensojmë. Unë propozoj që kjo të kalojë në asamble dhe të merret një vendim që të shndërrohet në objekt banimi,

Fadil Gashi: Hapi debat rreth këtij propozimi nga drejtori i Urbanizmit,

Enver Berisha: Realisht ky është objekti i cili është ndërtuar dhe ka mbetur me i pa shfrytëzueshmi, mirë kishte qenë ta gjejmë një zgjidhje adekuate, që të mund të shfrytëzohet më mirë, ne kemi pasur disa seli të

shoqatave të subjekteve të caktuara, ambienti aty ka qenë i tmerrshëm, shpresojmë që ta merr një karakter me ndryshe që të shfrytëzohet më mirë.

Lorenc Marleku: Aty ne duhet ta bëjmë një projekt, sepse ato janë zyrë, prandaj duhet bërë një projekt i mirëfilltë që ato zyrë të shndërrohen në objekte banimi,

Enver Berisha: Meqenëse seanca u shty për 28 shkurt, ka kohë të mjaftueshme që drejtori ta sjell një plan të punës për seancë në mënyrë që ta kuptojmë çka po kërkohet aty të veprohet, në mënyrë që me i bind asamblistët përse duhet ta ndërrojmë destinimin.

Xhevxhet Berisha, tha se e përkrahi Enverin, duhet ta kemi një plan, por edhe një listë të atyre që u kemi borxhe ne si komunë, të planifikohen dhe para asamblesë të kemi parasysh që ne si komunë mos të sillemi nëpër gjykata për të gjithë ata që i kanë humbur metrat katrorë, dhe se për miratim do të do të kalonte shumë më lehtë kur do të arsyetohej ndërrimi i destinimit nga objekt afarist në objekt banimi.

Fadil Gashi: Unë mendoj se plani i ndërrimit është diçka tjetër që kërkoi Enveri dhe arsyeja pse duhet të ndërrohet destinimi e tha drejtori, është i vetmi objekt që komuna ka përqindjen me të madhe me 42% është mirë që ta kemi edhe një listë të cilëve komuna u ka borxh metra katrorë, sepse unë e di që ata kanë përfituar me shumë.

Lorenc Marleku: Këtu ka lënde të vjetra ne gjykatë, janë dy apo tri lënde me vite tek unë janë pesë kërkesa dy janë të shqyrtuara, por ata i kanë pasur nga 50 metra katrorë. Ne si komunë iu kemi dhënë 10 metra katrorë më shumë për shkak se jemi vonuar, aty s'kemi objekt 60 metra katrorë, ka 70 dhe me shumë ata nuk kanë të holla ta paguajnë diferencën, po bëjmë përpjekje ta bëjmë në ato metra katrorë që të mos ketë nevojë as të paguajë ai dhe as t'i kthejmë ne.

Enver Berisha: Mendoj që këto janë dy gjena krejtësisht të ndara, çështja e ndërrimit të destinimit dhe e një plani se çka mund të nxjerr komuna në atë objekt është çështje tjetër, meqë po kërkohet me u kompensuar X personat që mund të jen dëmtuar kjo është fazë e mëvonshme. Ne duhet ta shikojmë fillimisht ndërrimin e destinimit se çfarë forme do të merr, çfarë plani, çka mund të nxjerr komuna aty?

Fadil Gashi: E hodhi në votim: kush është që kjo kërkesë të rekomandohet për kuvend?

Të gjithë ishin pro.

8. Kërkesat e arritura KPF-së në muajin janar-shkurt 2019.

Fadil Gashi: Kemi dy kërkesa për ndihmë financiare, një është nga Esmeralda Gjina nga Klina, kërkon nga Komiteti për Politik dhe Financa që t'i dal ne ndihmë, është futbolliste e klubit "Dukagjini" nga Klina, gjatë lojës në Kaçanik ka lënduar ligamentet e gjurit dhe operimi i tij ka një kosto prej 3000 euro, ka theksuar se kërkesën e bën për 1000 euro dhe pjesën tjetër besoj në ndihma tjera, dhe kërkesa tjetër vjen nga KFF "DUKAGJINI" Klinë kërkon nga Komiteti për Politik dhe Financa, që t'i dal në ndihmë futbollistes Dafina Bytyqi nga Fush Kosova, e cila ka lënduar ligamentet e gjurit dhe operimi i tij ka një kosto prej 3000 euro, ka theksuar se kërkesën e bën për 1000 euro dhe pjesën tjetër besoj në ndihma tjera.

Xhevxhet Berisha: Janë dy vajza se kanë të njëjtin lëndim ligamentin e gjurit, me pas mundësi me kthyer situatën para lëndimi. Unë besoj që të dyja këto na i kishin deponuar në konto të klubit nga 2000 euro, është lëndim jashtëzakonisht i rëndë, te dyja deklarojnë se situatën financiare e kanë të vështirë, prandaj ka qenë mirë që ta rekomandojmë për seancë.

Fadil Gashi: Duhet me e rekomanduar për seancë që të ndihmohet me mundësi buxhetore.

Enver Berisha: Më vjen keq nga të dyja vajzat për këtë lëndim. Unë e kam pasur rastin në familje, djali i vëllait ka pas të lënduar ligamentet dhe ka bërë po këtë operim. Këtu ka dy mundësi: ta operojë në institucione shtetërore ose në atë privatë. Unë të parën nuk kam mundur ta shfrytëzoj, por këto si klube kam informacion që mund të kenë përparësi. I njëjti mjek, i cili i kryen operimin në spital privat 3000 euro e operon edhe në spital të shtetit, por ka qenë mirë që Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, bashkë me klubin me iu drejtuar edhe Ministrisë së Kulturës dhe Sportit, sepse kam informacione zyrtare se aty shkojnë me kërkesë të klubit dhe operimi kryhet më shpejt për ndryshe radhët janë shumë të gjata, por ka qenë mirë me e shfrytëzuar situatën, meqë është klub me intervenuar në spital të shtetit dhe me iu ndihmuar këtyre vajzave.

Tunë Dedaj: Duhet të gjendet një zgjidhje dhe të operohen në spital të shtetit, sepse nuk janë vetëm këto dy raste me këtë lëndim ka edhe shumë raste tjera dhe po t'u ndihmoj të gjithë Komuna se di a kishte pasur mundësi me ia dalë. Por të shikohet në të ardhmen duhet të ndërmarrim ndonjë veprim që t'u ndihmojmë këtyre dy vajzave.

Enver Berisha: Nuk e përjashtoj mundësinë edhe te ndarjes se mjeteve, por nëse mund ta shfrytëzojnë mundësinë ta kryejnë këtë operim në spitalin e shtetit ka qenë mirë.

Xhevxhet Berisha: Kërkoj që të rekomandohet për seancë dhe brenda mundësive t'u ndahet një shumë e mjeteve, dhe në qoftë se ato e kryejnë operacionin pa pagesë ajo shumë me ju kthyer prapë Komunës. Kisha kërkuar që kjo të diskutohet në seancën e radhës dhe t'u ndihmojmë, sepse po t'i lëmë më vonë mund të kenë pasoja të parehabilitueshme,

Enver Berisha, tha se ka qenë mirë që deri në seancën e ardhshme me provuar variantin e parë, qoftë drejtoritë, qoftë ndokush tjetër.

Fadil Gashi, tha se le t'i merr këto si rekomandim Shërbimi i Kuvendit, ta bëj një rekomandim një t'ia dërgoj Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe një t'ia dërgojë Drejtorisë së Shëndetësisë, që të mundohen të gjejnë një zgjidhje deri në seancën e radhës.

Violeta Zefi, tha se unë i bashkëngjitëm kërkesës së Xhevxhetit, që ta rekomandojmë për seancë, sepse këto operime vështirë janë të arritshme të kryhen në institucionet publike, sepse radha është e gjatë, përpos kësaj janë kërkesa shumë specifike që duhet të plotësohen prej pacienteve në këtë rast në mënyrë që me ardhur në konsideratë për operim. Po e them këtë duke u bazuar edhe në disa raste të familjarëve, kështu që mendoj se duhet të shqyrtohet edhe në seancë.

Fadil Gashi: Propozoj variantin të cilin e propozoi Enver Berisha: le ta provojë që operimi të kryhet në institucionet publike dhe në rast se nuk arrihet le ta shqyrtojmë mundësinë e ndarjes së mjeteve.

Kryesuesi e hodhi në votimin propozimin.

Të gjithë ishin pro këtij propozimi, përpos Xhevxhet Berisha, i cili abstenoj.

Kërkesë tjetër është nga Komiteti Konsultativ i Bujqësisë, krekës për futje në rënd dite si pikë diskutimi plotësimin e kushteve për punë në Zyrën e Autoritetit Pyjor Komunal të Komunës së Klinës dhe ndalimin e hedhjes së mbeturinave në lumenj.

Për këtë pikë kërkojmë edhe nga Inspektorati që të marrim masa, edhe kjo u rekomandua për Kuvend
Të gjithë ishin pro.

Kërkesë tjetër Grupi i Grave asambliste dhe OJQ ZANA

Të formohet grupi joformal i grave anëtare të Kuvendit të Komunës së Klinës. Grupi joformal i Grave do të përbëhet prej anëtareve të Kuvendit të Komunës, Zyrës për barazi gjinore të Komunës së Klinës, si dhe në këtë grup pjesë do të jetë edhe OJQ ZANA, zyrtarja për Komunitete, Silvija Rashkoviq, përfaqësuesja nga komuniteti egjiptian, Mire Rama,

Enver Berisha, tha se nëse ka dakordancë në mes Grupit të grave asambliste dhe Zyrës së Komunitetit që janë edhe organizatë joqeveritare kish me qenë krejt në rregull, s'ka nevojë që kjo të debatohet.

Fadil Gashi: Kërkes nga Ibish Racit –që të hyjë si pikë e rendit të ditës për Kuvend-Shqyrtimi për ndryshim të vijës rregulluese në bllokun F5 në parcelat 515/4 dhe 515/6, për të cilat mendohet që janë bërë gabime teknike-vija ndërtimore e asaj zone, e cila përfshin pjesën nga hekurudha dhe nga hapësira e gjelbër.

KPF-rekomandon që deri në seancën e radhës, të kompletohet lënda nga dy drejtoritë: Drejtoria e Urbanizmit dhe MM, ajo e Kadastrit dhe Zyra ligjore në mënyrë që të mund të vihet deri të një vendim-konform dispozitave ligjore.

Kërkesë nga Drejtoria për Arsim.

Arben Limanaj: Përshëndeti të gjithë, kam një krekës në bazë të rregullores që nxjerr Komuna, për ndarjen e mirënjohjeve, titujve, çmimeve, që i ndanë Komuna na obligon edhe ne si Drejtori që kur të ndajmë qoftë edhe një mirënjohje ose një çmim që është i rregulluar me Rregulloren Komunale, po e zamë ne në arsim e kemi çmimin "Frrok Gojani" në lëmin e arsimit. Unë kisha kërkuar që në seancën e radhës të Asamblesë Komunale të jetë tek pika të ndryshme siç e patëm në seancën e kaluar rastin që u formua komisioni për sportistin e vitit, dhe ne kërkojmë të hyj si pikë e rendit të ditës kërkesa për formimin e komisionit, për ndarjen e çmimeve dhe mirënjohjeve me rastin e 7 Marsit, Ditës së mësuesit, si dhe për ndarjen e mirënjohjeve nga ana e Drejtorisë për mësuesit e dalë në pension.

Fadil Gashi, tha se këtë duhet ta lemë si pikë e rendit të ditës në asamble.

Enver Berisha tha se unë po pajtohem plotësisht me drejtorin për këtë kërkesë. Kërkoj që kjo të hyj në seancë, është mirë që ne sa herë që tash e tutje formojmë ndonjë komision që bazohet në rregullore dhe në vendime që i kemi nxjerr ne si asamble me qenë ai Komision i formuar me mandat deri në fund të mandatit të asamblesë dhe jo të formojmë komision pas komisioni, por nëse duhet ta formojmë një komision për arsim që ato mirënjohje, qoftë për 7 Mars, qoftë ndonjë çmim tjetër, me qenë i njëjti komision.

Fadil Gashi: Ne duhet ta rekomandojmë në seancë që komisioni të jetë i përhershëm dhe të jetë funksional sa mandati i asamblesë.

Tunë Dedaj, tha e falënderoj drejtorin që ka bërë kërkesën me kohë, duke marr parasysh që kërkesa e drejtorisë së Kulturës, Rinis dhe Sportit është bërë me vonesë dhe kemi qen shumë të vonuar, sepse është dashur ta zgjedhim sportistin e vitit dhe te jepet ai çmim në fund të vitit. Ne dje kemi prurë vendim, ne e rekomandojmë për seancë dhe çdo gjë përfundojë me kohë.

Fadil Gashi: edhe unë mendoj që është bërë me vonës kërkesa e Drejtorisë së Sportit, në të ardhmen është mirë që komisioni të lidhet me mandatë. Nëse ka dikush diçka urdhëroni, nëse jo kush është për?

Të gjithë ishin që kërkesa të kalojë për Kuvend.

Kërkesë nga Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal rreth miratimit të Statutit të Qendrës për Punë Sociale të Komunës së Klinës kanë kërkuar që të bëjnë disa ndryshime jo shumë të mëdha, dhe kërkesë tjetër nga Ministria është që Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale. Unë propozoj që ne si Komitet që komisionet që kanë punuar të merren me këto dy çështje dhe t'i sjellin me ato harmonizime që janë kërkuar. Nuk kanë kërkuar që të anulohet, por vetëm një përmirësim dhe pasi të bëhen këto ndërhyrje të sillen në seancën e radhës, më 28 shkurt.

Kryesuesi përshëndeti të gjithë për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë në këtë seancë dhe seancën e konstatoi të mbyllur.

Mbledhja përfundoj në ora 11:30.

Procesmbajtësi,
Ahmet Berisha

